

GJKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Nebojsa Boriçiq, kryetar, Gyltene Sylejmani dhe Erdogan Haxhibeqiri, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në konfliktin administrativ sipas paditëses Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) sh.a. në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson R. D., kundër të paditurës Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), të cilën me autorizim e përfaqësojnë A. S., G. B. dhe Y. F., për shkak të anulimit të vendimit nr.V dt....., duke vendosur lidhur me kërkesën e të paditëses kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.UZH.nr.369/2016 dt.31.05.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me 15.11.2017, mori këtë

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar kërkesa e paditëses Korporata Energjetike e Kosovës sh.a. për rishqyrtim të jashtëzakonshëm, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.UZH.nr.369/2016 të datës 31.05.2017.

Arsyetim

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.UZH.nr.369/2016 të datës 31.05.2017, është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditëses Korporata Energjetike e Kosovës (shkurt.KEK) sh.a. paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamentit për çështje administrative A.U.nr.620/2013 dt.28.09.2016 me të cilën është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses (KEK) sh.a. lidhur me anulimin e vendimit të Zyrës së Rregullatorit për Energji (shkurt.ZRRE) nr.V dt.....

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit AA.UZH.nr.369/2016 dt.31.05.2017, paditësja ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm, për shkak të shkeljes të së drejtës materiale dhe të shkeljes së dispozitave të procedurave, me propozim që të aprovohet kërkesa, të anulohen aktgjykimet e goditura dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi shkresat e lëndës, pretendimet në kërkesë, përgjigjen e të paditurës, dhe pas vlerësimit të aktgjykimit të goditur në pajtim me nenin 53 të Ligjit për konfliktin administrativ (LKA), ka gjetur se:

Kërkesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktgjykimin e goditur të Gjykatës së Apelit AA.UZH.nr.369/2016 dt.31.05.2017 është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditëses (KEK) paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Thmlore në Prishtinë-Dep.administrativ A.U.nr.620/2-13 dt.28.09.2016 me të cilën është refuzuar kërkesëpadia e KEK-ut, lidhur me anulimin e vendimit e të paditurës (ZRRE) nr..... dt.....

Gjykata Supreme e Kosovës, duke e shqyrtuar kërkesën e paditëses gjen se gjykata e shkallës së dytë ka vepruar drejtë duke e refuzuar ankesën e paditëses. Qendrimin juridik të gjykatave të instancës më të ulët si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e aprovon edhe kjo Gjykatë, për arsye se aktgjykimet e kontestuar nuk janë përfshirë më shkelje qenësore të drejtës materiale siç pretendohet në kërkesë.

Sipas nenit 14 (paragrafit 2) të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë përcaktohen detyrat dhe kompetencat për përgatitjen dhe miratimin e metodologjisë tarifore në zgjidhjen e kontesteve që kanë të bëjnë me çështjet e licencave të lëshuara nga ZRE, ndërmjet konsumatorëve dhe ndërmarrjeve për energji, operatorëve të sistemit dhe ndërmarrjeve energjetike, si dhe ndërmjet dy ndërmarrjeve energjetike. Poashtu, e paditura (ZRRE) nxjerrë rregulla dhe vendime individuale në pajtim me këtë ligj. Neni 43.1 të njëjtit ligji përcakton se ZRRE miraton tarifat për shërbimet e rregulluara të energjisë bazuar në metodologjitë e tarifave për tarifat e rregulluara dhe në propozimet për rishikimin e tarifave të dorëzuar nga ndërmarrjet e energjisë. Kurse me dispozitën e nenit 17 të Ligjit për Energjinë, përcaktohet se të gjitha tarifat e rregulluara dhe metodologjitë tarifore duhet ti mundësojnë ndërmarrjes së rregulluar të energjisë mundësinë që të ngarkojë me tarifa dhe të kthejë koston e arsyeshme të plotë vjetore për shërbime. Paragrafi 4.11.1 i metodologjisë tarifore për sektorin e energjisë elektrike, parashikon përgatitjen e Operatorit të Sistemit të Transmisionit (OST) lidhur me barazimin e vlerës aktuale me atë të përcaktuar, dhe kjo duhet bëhet çdo vjet.

Gjykata Supreme vlerëson se gjykatat e instancave më të ulëta në mënyrë të plotë dhe të drejtë kanë zbatuar dispozitat ligjore, duke e refuzuar si të pabazuar kërkesën e paditëses. Gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka vlerësuar se ka mospërputhje të të dhënave me draft pasqyrat financiare të dërguara nga paditësja tek e paditura me datën ... dhe ... gjatë aplikimit për të hyrat të lejuara maksimale të cilat nuk i ka paraqitur, obligim ky i paditëses e cila nuk i ka dorëzuar pasqyrat financiare të auditura deri më, detyrim ky ligjor i paditëses, nga neni 2 i Licencës. Në këtë kuptim gjykata vlerëson se e paditura, drejtë ka vendosur me vendimin nr.... të datës, kur ka aprovuar të hyrat maksimale të lejuara që do të mblidhen nga tarifat me pakicë të energjisë elektrike që do të aplikohen nga furnizuesi publik për vitin relevant prej 12 muajve (nga deri më ...).

Kjo Gjykatë i vlerëson si të pabazuara pretendimet e paditëses se, e paditura është dashtë ta aplikojë, për shkak të mungesës së faktorit të përshtatjes së të hyrave, në rregullat për vendosjen e çmimeve, nga fakti se implementimi i faktorit të përshtatjes ka qenë i pamundur të realizohet, ngase paditësja deri me dt....., kur ka ndosur privatizimi i saj, ka qenë ndërmarrje e integruar dhe se, e paditura ka implementuar nenin 5.1,2 dhe 3 të Rregullës për vendosjen e çmimeve të FPPE, faktorin e

përshatatjes-KREV. Në këtë rast llogaritë e të licencuarve nuk kanë qenë të ndara, dhe në këtë kuptim, e paditura drejtë ka vendosur kur ka ardhë në përfundim se paditësja ka ofruar të dhëna të pasakta dhe të pamjaftueshme për kalkulimin e këtyre përshtatjeve dhe në këtë rast, e paditura nuk ka mundur ti pranojë pretendimet e paditëses dhe ti ngarkojë konsumatorët me detyrime të pabazuar, ngase kjo do të ishte në kundërshtim me Rregullen për vendosjen e çmimeve. Neni 9.1 përcakton se të hyrat e lejuara maksimale do të jenë të barabarta me kostot e arsyeshme për ofrimin e shërbimeve standarde për konsumatorët, dhe me kusht që këto kosto të jenë të arsyeshme dhe të matura saktësisht. Pretendimi ankimor i paditëses se gjykatat nuk kanë marrë për bazë nenin 5.3 nenpar.3.2 të Rregullës për vendosjen e çmimeve, nuk qëndron, pasi që e paditura ka zbatuar nenin e lartpërmendur, duke përdorur vetëm ato të dhëna të cilat kanë qenë të sakta nga të licencuarit. Meqenëse, është vërtetuar se paditësja ka dërguar të dhëna të pa sakta gjatë periudhës së shqyrtimit të të hyrave të lejuara maksimale, dhe si rezultat i kësaj e paditura nuk ka mundur të ngarkojë konsumatorët me kosto të cilat nuk janë dëshmuar, e të cilat do të kishin ndikim në rritjen e tarifave të energjisë elektrike për konsumatorët.

Duke u bazuar në arsyet e dhëna, Gjykata Supreme gjeti se janë të pabazuara thëniet e paditësit lidhur me shkeljet, sepse ato nuk ndikojnë në nxjerrjen e vendimit të ndryshëm nga ai që ka gjetur gjykata e shkallës së dytë dhe se vendimi i goditur është i qartë dhe i kuptueshëm. Arsyetimi i aktgjyqimit të goditur përmbanë arsye të mjaftueshme dhe faktet vendimtare për marrjen e vendimeve të ligjshme. Po ashtu, kjo Gjykatë vlerëson se është bërë aplikimi i drejt të drejtës materiale dhe se ligji nuk është shkelur në dëm të paditëses.

Nga sa u tha më lartë dhe në pajtim me nenin 54.1 të LKA-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjyqimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

ARJ.UZVP.nr.45/2017 dt. 15.11.2017.

Procesmbajtësi,

Bujar Balaj

Kryetari i kolegjit,

Nebojsa Boriçiq

Përktheu: F. A.